

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

BAZA LIGJORE

Nenet 6, 761 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

Sot më datë 02.05.2024 (dymijëenjetekater) në zyrat e shoqërisë GEGA ENERGY.shpk u paraqitën palët:

DHURUESI:

Z.Paulin Gega, atësia Pjetër, amësia Rozë, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Bulevardi Zogu I Neë York; Nd. 0; H. Shk.1; Ap. Ap.21; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 20/08/1965, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letemjofitim ID nr. 033486515 dhe nr. personal G50820106F;

Z.Agim Janko, atësia Mihal, amësia Marije, shtetas Shqiptar, lindur në Divjake dhe banues në Divjake, Nd.248, H.0, ap .0 , Divjake, Divjake, 9022 Divjake, lindur më 20/03/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjofitim ID nr. 037112315 dhe nr. personal G80320062U.

PRANUESI I DHURIMIT :

Z.Çesk KIMÇA, atësia Ejll, amësia Kushë, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, me adresë Lagjia Skënërbeg, Shkolla Pyjore Shkodër, rruga Luke Kacej 03310265, Nd.6, h.1, Shkodër, Shkodër, 4001, Shkodër, lindur më 17.07.1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjofitim ID nr. 033734367 dhe nr. personal G80717078D.

Palët me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe në mirëkuptim të ndërsjelltë, me kërkuan redaktimin e kësaj kontrate, në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:

TË DHËNA PARAPRAKE:

Dhuruesi **Z.Paulin Gega** ka në pronësi pasurinë e luajtshme, 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "GEGA ENERGY"shpk, identifikuar me numer unik identifikimi M41612026U, themeluar dhe regjistruar më datë 12.04.2024, me seli në Tirane, Njesia Nr.1, rruga Ali Demi, godina Nr.110, pasuria Nr.8/745, ZK.8150, Tiranë, Shqipëri.

Z.Agim Janko, ka në pronësi pasurinë e luajtshme, 49 % (dyzetënëntë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "GEGA ENERGY"shpk, identifikuar me numer unik identifikimi M41612026U, themeluar dhe regjistruar më datë 12.04.2024, me seli në Tirane, Njesia Nr.1, rruga Ali Demi, godina Nr.110, pasuria Nr.8/745, ZK.8150, Tiranë, Shqipëri.

NENI 1

Objekti i kësaj kontrate është dhurimi e pasurisë së luajtshme, 30 % (tridhjet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "GEGA ENERGY"shpk, nga dhuruesi në favor të pranuesit te dhurimit i ndarë në :

Z.Paulin Gega dhuron 21 (njëzetënjë përqind) të kuotave të kapitalit;

Z.Agim Janko dhuron 9 (nëntë përqind) të kuotave të kapitalit;



Ku në total pranuesi i dhurimit Z.Çesk KIMÇA përfiton 30 % (tridhjet përqind) të kuotave të kapitalit.

NENI 2

Dhuruesit ia dhurojnë këtë pasuri pranuesit të dhurimit 30 % (tridhjet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “**GEGA ENERGY**”shpk, të ndara **30 % (tridhjet përqind) për Z.Çesk KIMÇA.**

NENI 3

TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit për titullin e pronësisë të pasurisë objekt kontrate dhe për saktësinë e dokumentacionit zyrtar të saj, në të kundërt mban përgjegjësi civile për dëmin e shkaktuar;

Dhuruesi është i detyruar t’i dorëzojë pasurinë objekt kontrate me të gjithë dokumentacionin përkatës pranuesit të dhurimit,

Dhuruesi është i detyruar t’i dorëzojë pasurinë objekt kontrate pranuesit të dhurimit të shkarkuar nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve;

Pranuesi i Dhurimit ka detyrim të njoftojë brenda pesë ditëve Dhuruesin në rast se të tretët, ngrënë pretendime pronësie mbi sendin objekt kontrate.

NENI 4

KALIMI I PRONËSISË

Me nënshkrimin e kontratës, dhuruesi :

Z.Paulin Gega zhvishet 21 (njëzetënjë përqind) nga pronësia mbi pasurinë objekt kontrate dhe ajo i kalon pjesërisht 21 (njëzetënjë përqind) **Z.Çesk KIMÇA.**

Z.Agim Janko zhvishet 9 (nëntë përqind) nga pronësia mbi pasurinë objekt kontrate dhe ajo i kalon pjesërisht 9 (nëntë përqind) **Z.Çesk KIMÇA.**

Pranuesi i dhurimit bëhet zotëruar të **30 % (tridhjet përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “GEGA ENERGY”shpk.**

NENI 5

TË NDRYSHME

Palët u porositën që të depozitojnë këtë kontratë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranës.

Kontrata iu lexohet palëve të cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi.

Kontrata redaktohet në katër kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, bashkëlidhur kësaj kontrate janë kopje e ekstraktit të QKR-së të Shoqërisë Vendimi i Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë Nr.02, datë 02.05.2024, si dhe dokumentat e identifikimit te paleve.

PALËT

DHURUES

ORTAKU
Z.Paulin Gega



ORTAKU
Z.Agim Janko



PRANUES I DHURIMIT

Z.Çesk KIMÇA
